VENDIM
Nr. 853, datë 4.11.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KËSHILLIT TË QARKUT KUKËS TË NJË PJESE TË PASURISË NR. 23/70, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 2315

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave te paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Këshillit të Qarkut Kukës të sipërfaqes 23.92 (njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e dy) m^2, të katit përdhes, të sipërfaqes 262.78 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy pikë shtatëdhjetë e tetë) m^2, të katit të dytë dhe të sipërfaqes 105.91 (njëqind e pesë pikë nëntëdhjetë e një) m^2, të katit të tretë, pjesë të pasurisë nr. 23/70, zona kadastrale 2315, sipas formularit dhe planimetrive që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Këshillit të Qarkut Kukës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
3. Ngarkohen Këshilli i Qarkut Kukës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Institucioni: Keshilli Qarkut Kukës
Fusha e përdorimit të Pronës: Administratë
Identifikoi: Ing. Beglije Cenaj, Specialist e P.Territorit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Ing. Omer Llukovi, P/Sektorit te Sh.Publike dhe te P.Territorit (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Abdulla Domi, Kryetar i Keshillit te Qarkut Kukës (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

A			B				C			
Nr.	Zona	Nr.	Emërtesa e Pronës	Komponentët	Adresa/Vendndodhja	Përmasat e	Funksioni për të	Institucioni/Enti	Institucioni/Enti	Te dhëna të tjera

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT
KUKËS



PLANIMETRIA E KATIT TRETË



Sip.ndërtimi me hapësirë shfrytëzimi nga zyrat e QARKU KUKËS 105.91 m^2

Matjet në terren:
Ing. Sali Shehu
Ing. Oltjon Gaxha

Punoi planimetritë:
Ing. Ardit Halilaj